Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**11.08.2023**	**22.08.2023**	**2023/0554**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 07.08.2023, OE “" EJONA " SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0554, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirembajtja e ashensoreve per objektet e Komunes se Prishtines dhe Mirembajtja e ashensoreve per objektet e banimit kolektiv” me nr. të prokurimit: "616-23-4207-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratse: sherbim, vlera e parashikuar e kontrates; 650,000.00 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 28.04.2023, Data e njoftimit për dhënie të kontratë 31.07.2023, data e hapjes së ofertës: 05.06.2023, data e vendimit për dhënien e kontratës: 20.07.2023, data e njoftimit të me letër standarde: 20.07.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

PRETENDIMI 1) - SELMANS NETWORK & ROMAY

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

40.7 "Në pajtueshmëri" nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në dosje të tenderit duke mos u larguar në mënyrë thelbësore nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime. "Largime dhe kufizime thelbësore janë ato të cilat:

(i) Dallojnë esencialisht nga kushtet dhe specifikimet e dosjes së tenderit; dhe/ose

(ii) Afektojnë parametrat, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës; dhe/ose

(iii) Kufizon të drejtat e AK ose obligimet e tenderuesit sipas kontratës; dhe/ose

(iv) Shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me rregullat.

26.6 Çertifkatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifkata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.

RREGULLORE (MTI) NR. 05/2018 PËR SIGURINË E ASHENSORËVE NË PËRDORIM

Neni 5 Mirëmbajtësi i ashensorit 1. Mirëmbajtësi është person fizik ose juridik i regjistruar në Kosovë, i cili siguron dhe kryen mirëmbajtjen e ashensorit nga persona kompetent për mirëmbajtje në emër të pronarit, me trajnim adekuat, të kualifikuar me njohuri dhe përvojë praktike, të pajisur me udhëzimet e nevojshme për të mundësuar kryerjen e veprimeve të nevojshme të mirëmbajtjes në mënyrë të sigurte. 2. Kualifikimi i mirëmbajtësit sigurohet me certifikatën e sistemit të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me standardin SK EN ISO 9001 verzioni i fundit. Certifikata e sistemit të menaxhimit të cilësisë kërkohet një (1) vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore.

PRETENDIMI 2) - SELMANS NETWORK & ROMAY Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët 41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

ii. ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

KRITERET PËR VLERËSIM

2. Operatori ekonomik për LOT 1 dhe LOT 2 duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme a. Inxhinier i diplomuar ose bachelor i elektroteknikes. Minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë menaxhuar kontrata të natyrës së ngjashme. b. Inxhinier i diplomuar ose bachelor i makinerisë. Minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë menaxhuar kontrata të natyrës së ngjashme. c. 3 ekipe me nga 2 teknikë të makinerisë ose elektros. Minimumi 3 vite përvojë pune në punë të ngjashme.

2. Për pikën a) dhe b) CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për inxhinierin e elektroteknikës dhe inxhinierin e makinerisë. Për pikën c) marrëveshjen për angazhim apo kontratat si dhe CV.

3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj ISO STANDARDET që lidhen me natyrën e aktivitetit për LOT1 dhe LOT2 si në vijim a) ISO 9001 2015; b) ISO 14001 2015; c) ISO OHSAS 18001.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i papërgjegjshëm

OE i rekomanduar për kontrate eshte i përgjegjshëm

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" EJONA " SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues " EJONA " SH.P.K i pakënaqur me vendimin e AK-se për Lot 1 (njoftohet edhe me letrën standarde si tenderues i pasuksesshëm), konform nenit 108/A ka parashtruar ankese me pretendimin se AK-ja, nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 te LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit sa i përket:

3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj ISO STANDARDET që lidhen me natyrën e aktivitetit për LOT1 dhe LOT2 si në vijim a) ISO 9001 2015; b) ISO 14001 2015; c) ISO OHSAS 18001.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar ISO Standardet e Liderit te grupit, vlerëson se qëndron pretendimi i OE ankues, për faktin se i rekomanduari për kontrate ka dorëzuar ISO standarde ne te cilat jepet një përshkrim i përgjithësuar, pra nuk përmendet konkretisht mirëmbajtja e ashensorëve. Vlen te përmendet fakti se anëtari i konzorciumit i ka dorëzuar Iso Standardet pikërisht për mirëmbajtje te ashensorëve.

Megjithatë eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja, është dashur ti verifikoje sipas nenit 72 te LPP-se, sepse përshkrim te ISO standardit te dorëzuar nga i rekomanduari për kontrate, thuhet:

"Selmans Network" sh.p.k.

Prishtinë, Rruga Jakov Xoxa, Kopleksi Blini, Co, pn, Republika e Kosovës

Has been assessed and found to be in Compliance with the requirements of Standard detailed below

ISO 9001:2015

Quality Management System

This certificate is valid for the following Services

Cleaning and maintenance for interior of buildings. Other construction installation. Other building completion and finishing. Other specialised construction activities.

Pra, nga përshkrimi i dhënë me larte, nënkuptohet se i rekomanduari për kontrate është i certifikuar edhe për aktivitete tjera te specializuara ne ndërtim, qe mund te nënkuptohen se përfshihet edhe pjesa e mirëmbajtës se ashensorëve. Pra, certifikatat e dorëzuara nuk japin një përshkrim me te detajuar se janë edhe për mirëmbajtje te ashensorëve. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se verifikimi është i nevojshëm.

OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate, ku AK-ja ne dosje ka kërkuar për stafin profesional, konkretisht për inxhinierin e elektros, qe i njëjti duhet te ketë menaxhuar kontrata te natyrës se ngjashme.

Eksperti shqyrtues, sqaron se ne CV-in e tij nuk ka emërtuar asnjë projekte qe inxhinieri i elektros i dorëzuar ne ofertën e te rekomanduarit për kontrate ta ketë menaxhuar ndonjë kontrate te natyrës se ngjashme dhe poashtu edhe ne referencat te cilat vet OE Selmans Network i ka lëshuar për inxhinierin e vet, nuk e ka përmendur se i njëjti ka qene menaxher ne ndonjë projekt te ngjashëm. Prandaj ky pretendim i OE ankues qëndron.

Poashtu qëndron pretendimi i OE ankues edhe sa i përket inxhinierit i makinerisë Afrim Gashi, sepse AK-ja, ngjashëm sikurse te inxhinieri i elektros ka kërkuar qe edhe inxhinieri ne fjale te ketë menaxhuar projekte te ngjashme, dhe nga deshmit e prezantuara nuk figuron se i njëjti ka menaxhuar

projekte te ngjashëm.

OE ankues, ne ankesën e tij pretendon se i rekomanduari për kontrate, ka ofruar çmime Jo/Nomralishte te ulëta, duke u cekur disa pozicione te paramanës se tij.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se ne baze te nenit 61 te LPP-se, vlerësimi i çmimeve është e drejte e autoritetit kontraktues dhe njeherit sqaroje se OE ankues nuk ka ofruar ndonjë prove bindëse lidhur me çmimet për te cilat pretendon.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" EJONA " SH.P.K.**

Florije Rexhepi